

Takimi i 1521-të , 4-6 Mars 2025 (DNj)

H46 -2 Strazimiri kundër Shqipërisë (Kërkesa nr. 34602/16)

Mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane

Dokument referencë
CM/Shënime/1521/ H46 -2

Vendimet

Delegatët

1. rikujtuan se kjo çështje ka të bëjë me trajtimin çnjerëzor dhe degradues të kërkuarit për shkak të efektit kumulativ të kushteve të këqija materiale në Spitalin e Burgut të Tiranës dhe trajtimit të pamjaftueshëm psikiatrik dhe terapeutik, arrestit të tij të paligjshëm, pasi ai nuk ishte vendosur në një institucion mjekësor të posaçëm siç e kërkon ligji vendas dhe nuk i ishte ofruar as kujdesi i duhur terapeutik si dhe dështimi i gjykatave për të shqyrtuar me shpejtësi një apel që kundërshton ligjshmërinë e arrestit të tij dhe mungesën e të drejtës për kompensim për shkeljet e së drejtës së tij për liri.

Për sa u përket masave individuale

2. ftuan autoritetet të vijojnë të paraqesin informacion mbi kushtet materiale të arrestit dhe trajtimit terapeutik të kërkuarit dhe vunë në dukje se miratimi i masave të mjaftueshme individuale në lidhje me këto çështje është i lidhur me miratimin e masave të përgjithshme;

3. duke vënë re se sipas të dhënave për rivlerësimin periodik gjyqësor të nevojës për mbajtjen e vazhdueshme të kërkuarit në arrest, ky rivlerësim nuk zhvillohet gjithmonë çdo vit, siç kërkohet nga legjislati brendshëm; ftuan edhe një herë autoritetet që të sigurojnë që ky rivlerësim të bëhet çdo vit, dhe kërkuari të dëgjohet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor;

Për sa u përket masave të përgjithshme

4. shprehën shqetësimin serioz se niveli i lartë i mbipopullimit në Institucionin e Posaçëm të Lezhës vijon pavarësisht masave afatshkurtra të mara nga autoritetet; i nxitën fort autoritetet që të dyfishojnë përpjekjet e tyre për zgjidhjen e këtij problemi sa më shpejt të jetë e mundur dhe i ftuan ato të japin një vlerësim mbi ndikimin e masave të miratuara, pengesat e hasura dhe masat e parashikuara më tej;

5. përsëritën edhe një herë thirrjen e Komitetit për një vlerësim të statistikave dhe rezultatit të shqyrtimit gjyqësor të nevojës për izolim të vazhdueshëm, dhe ftuan autoritetet të sigurojnë që pacientët psikiatrikë mjeko-ligjorë të dëgjohen personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor nga gjykatat; përsëritën thirrjet e tyre në lidhje me shkeljen e nenit 5 § 4, për shembuj të jurisprudence për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të gjykatës që urdhërojnë burgimin, për sqarim mbi mjetin juridik për të korrigjuar shkeljet e nenit 5 dhe për vlerësimin e autoriteteve nëse masa të mëtejshme specifike konsiderohen të nevojshme;

6. ftuan autoritetet të shtojnë përpjekjet e tyre për të rekrutuar staf të mjaftueshëm të specializuar në Institucionin e Posaçëm të Lezhës dhe për të mbajtur Komitetin të informuar rregullisht mbi rekrutimin e personelit; vunë re informacionin e dhënë për disponueshmërinë e qendrave të trajtimit ambulator të shëndetit mendor dhe ftuan autoritetet të sqarojnë aspekte të ndryshme të treguara në analizën e Sekretariatit në lidhje me funksionimin efektiv të tij;

7. duke vënë re informacionin e dhënë për hapat e mëtejshëm në planifikimin e ndërtimit të një institucioni të përhershëm të specializuar mjeko-ligjor psikiatrik dhe në sigurimin e financimit të tij, ftuan autoritetet që ta mbajnë Komitetin të informuar rregullisht mbi zhvillimet përkatëse dhe i inkurajuan ato të eksplorojnë mekanizma të ndryshëm financiarë të disponueshëm në nivel kombëtar ose rajonal dhe të diversifikojnë opsionet për mbledhjen e fondeve në këtë drejtim;
8. inkurajuan autoritetet që të vazhdojnë bashkëpunimin e tyre me Këshillin e Evropës, veçanërisht nëpërmjet Programit të Instrumentit Horizontal III 2023-2026 “Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të dënuar në Shqipëri”;
9. ftuan autoritetet të paraqesin informacion mbi problematikat e mësipërme deri në fund të shtatorit 2025 dhe vendosën të rishqyrtojnë këtë çështje më së voni në mbledhjen e tyre në mars 2026 (DNj) .